Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister

RREGULLORE (ZKM) NR. 17/ 2026 PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM DHE SISTEMATIZIMIN E VENDEVE TË PUNËS NË AGJENCINË PËR REGJISTRIMIN E BIZNESEVE TË KOSOVËS[1]

[1] Rregullore (ZKM) Nr. 17/2026 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës, është miratuar nga Kryeministri me Vendimin Nr.108/2026, të datës 16.11.2026.

Kryeministri i Republikës së Kosovës

Në mbështetje të nenit 94 (3), të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 28, paragrafi 3, të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, të nenit 9, paragrafi 7, të Rregullores (QRK) Nr. 01/2020 për Standardet e Organizimit të Brendshëm, Sistematizimin e Vendeve të Punës dhe Bashkëpunimin në Institucionet e Administratës Shtetërore dhe Agjencitë e Pavarura;

Miraton:

RREGULLORE (ZKM) NR. 17/ 2026 PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM DHE SISTEMATIZIMIN E VENDEVE TË PUNËS NË AGJENCINË PËR REGJISTRIMIN E BIZNESEVE TË KOSOVËS

KAPITULLI I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Kjo Rregullore ka për qëllim përcaktimin e organizimit të brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës (ARBK), që funksionon si organ qendror i administratës shtetërore në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit.

Neni 2
Fushëveprimi

Kjo Rregullore zbatohet për Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës (ARBK). Parimet, procedurat dhe kompetencat e ARBK-së përcaktohen me Ligjin në fuqi për Shoqëritë Tregtare, Ligjin për Regjistrin e Pronarëve Përfitues dhe Ligjin për Regjistrimin e Pengut në Regjistër për Sendet e Luajtshme.

Neni 3
Përkufizimet

Shprehjet e përdorura në këtë Rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përcaktuar në Ligjin për Shoqëritë Tregtare, Ligjin për Regjistrin e Pronarëve Përfitues dhe Ligjin për Regjistrimin e Pengut në Regjistër për Sendet e Luajtshme.

KAPITULLI II
ORGANIZIMI I BRENDSHËM I AGJENCISË PËR REGJISTRIM TË BIZNESEVE NË KOSOVË

Neni 4
Misioni i ARBK-së

Misioni i ARBK-së është të mbështesë zhvillimin e një mjedisi të sigurt, transparent dhe të parashikueshëm për bizneset në Republikën e Kosovës, përmes rregullimit të qartë, administrimit të besueshëm të të dhënave publike dhe ofrimit të shërbimeve efikase që forcojnë sigurinë juridike, transparencën ndaj publikut dhe funksionimin e përgjithshëm të ekonomisë formale.

Neni 5
Struktura Organizative e Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës

1. Struktura organizative e ARBK-së është si në vijim:

1.1.Zyra e Drejtori Ekzekutiv

1.2.Departamentet dhe

1.3.Divizionet

2.Numri i të punësuarve në ARBK është dyzet e tetë (48).

Neni 6
Zyra e Drejtorit Ekzekutiv

1. Zyra e Drejtorit Ekzekutiv të ARBK-së përbëhet nga:

1.1.Drejtori Ekzekutiv;

1.2.Zyrtari i lartë ekzekutiv;

1.3.Zyrtarii lartë për komunikim me publikun;

1.4.Asistent administrativ;

1.5.Zyrtar i lartë për monitorim dhe kontroll; dhe

1.6.Zyrtar i lartë për raporte dhe analiza.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorit Ekzekutiv përcaktohen me Ligjin përkatës për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, me Ligjin për

Shoqëritë Tregtare, Ligjin për Pronar Përfitues, Ligjin për Regjistrimin e Pengut në Regjistër për Sendet e Luajtshme dhe me legjislacionin tjetër përkatës në fuqi.

3. Detyrat dhe përgjegjësitë e nëpunësve civilë dhe mbështetës në zyrën e Drejtorit Ekzekutiv përcaktohen në ligjin përkatës për zyrtarët publikë dhe legjislacionin tjetër në fuqi. Nëpunësit civilë dhe mbështetës në zyrën e Drejtorit Ekzekutiv raportojnë te Drejtori Ekzekutiv.

4. Numri i të punësuarve në zyrën e Drejtorit Ekzekutiv është gjashtë (6).

Neni 7
Departamentet dhe Divizionet tjera në kuadër të ARBK-së

1. Departamentet dhe Divizionet në kuadër të ARBK-së janë:

1.1. Departamenti për Regjistra

1.1.1. Divizioni për Regjistrin e Shoqërive Tregtare;

1.1.2. Divizioni për Regjistrin e Pronarëve Përfitues;

1.1.3.Divizioni për Regjistrin e Pengut.

1.2.Departamenti për Shërbime dhe të Dhëna

1.2.1.Divizioni për Mbështetje dhe Edukim të Bizneseve;

1.2.2.Divizioni për Shërbime Digjitale dhe të Dhëna.

Neni 8
Departamenti për Regjistra

1. Misioni i Departamentit për Regjistra, është të sigurojë administrimin e saktë të besueshëm dhe transparent të regjistrave publikë të bizneseve, pronarëve përfitues dhe pengut, si dhe të sigurojë funksionim efikas dhe transparent të sistemeve digjitale duke garantuar qasje të barabartë dhe efikase në shërbimet e ofruara drejt bizneseve dhe subjekteve të tjera të regjistrimit.

2. Departamenti për Regjistra, ka detyrat dhe përgjegjësitë në vijim:

2.1. Zhvillon procedurën administrative të regjistrimit të shoqërive tregtare, pronarëve përfitues dhe pengut sipas procedurave të përcaktuara me ligjet përkatëse në fuqi.

2.2. Zhvillon procedurën administrative të regjistrimit të degëve dhe zyrave përfaqësuese të shoqërive të huaja, ndërmarrjeve publike, ndërmarrjeve shoqërore nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe subjekteve të tjera që kërkojnë regjistrim në ARBK.

2.3. Zhvillon procedurën administrative për ndryshimet, plotësimet dhe çregjistrimet për të gjitha kategoritë e subjekteve të regjistrimit në ARBK.

2.4. Vendos të dhënat e procedurave administrative të zhvilluara në regjistrat përkatës në format fizik dhe elektronik, duke siguruar saktësinë, integritetin dhe përditësimin e tyre.

2.5. Bashkëpunon dhe koordinon me qendrat komunale të regjistrimit për zbatim uniform të procedurave lidhur me regjistrimin.

2.6. Përgatit formularë, autorizime dhe procedura standarde për lehtësimin e procedurave lidhur me regjistrimin.

2.7. Inicion procedura kundërvajtëse për shkeljet e parapara me ligjin për regjistrimin e pronarëve përfitues.

2.8. Siguron administrimin, mirëmbajtjen, funksionimin e pandërprerë dhe sigurinë e sistemeve elektronike të regjistrimit dhe të bazave të të dhënave të ARBK-së.

2.9. Përditëson dhe optimizon platformat online të ARBK-së, duke mundësuar qasje të lehtë, efikasitet dhe ndërveprim të sigurt me përdoruesit dhe institucionet e tjera.

3. Drejtori i Departamenti për Regjistra i raporton Drejtorit Ekzekutiv të ARBK-së.

4. Numri i të punësuarve në Departamentin për Regjistra është tridhjetë e tre (33).

Neni 9
Divizioni për Regjistrin e Shoqërive Tregtare

1. Divizioni për Regjistrin e Shoqërive Tregtare ka për qëllim të sigurojë regjistrimin dhe administrimin e shoqërive tregtare, duke garantuar saktësinë e të dhënave.

2. Divizioni për Regjistrin e Shoqërive Tregtare ka detyrat dhe përgjegjësitë në vijim:

2.1 Zhvillon procedurën administrative të regjistrimit të shoqërive tregtare, duke shqyrtuar kërkesat dhe dokumentacionin përkatës të pranuar;

2.2 Zhvillon procedurën administrative të regjistrimit të degëve dhe zyrave përfaqësuese të shoqërive të huaja, ndërmarrjeve publike dhe shoqërive nën administrimin e AKP-së, duke shqyrtuar kërkesat dhe dokumentacionin përkatës të pranuar;

2.3 Zhvillon procedurën administrative për ndryshimet, plotësimet dhe çregjistrimet e të dhënave të shoqërive tregtare, duke shqyrtuar kërkesat dhe dokumentacionin përkatës të pranuar;

2.4 Vendos të dhënat e shoqërive tregtare në regjistrin e shoqërive tregtare bazuar në procedurat standarde të veprimit të ARBK-së;

2.5 Pranon dhe verifikon kërkesat nga qendrat komunale për vendosje të të dhënave të shoqërive tregtare në regjistrin e shoqërive tregtare;
2.6 Përgatit formularë, autorizime dhe procedura standarde për lehtësimin e procedurave të regjistrimit;

2.7 Kontribuon në dhënien e sqarimeve dhe informacioneve për bizneset lidhur me procedurat përkatëse të regjistrimit të shoqërive tregtare, në bashkëpunim me njësitë e tjera të ARBK-së, me qëllim të sigurimit të transparencës dhe lehtësimit të procedurave administrative;

2.8 Menaxhon dokumentacionin e pranuar, në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi.

3. Udhëheqësi i Divizionit për Regjistrin e Shoqërive Tregtare i raporton Drejtorit të Departamentit për Regjistra.

4. Numri i të punësuarve në Divizionin për Regjistrin e Shoqërive Tregtare është nëntëmbëdhjetë (19).

Neni 10
Divizioni për Regjistrin e Pronarëve Përfitues

1. Divizioni për Regjistrin e Pronarëve Përfitues ka për qëllim të sigurojë regjistrimin dhe administrimin e të dhënave për pronarët përfitues, duke garantuar saktësinë dhe integritetin e regjistrit, funksionimin e sistemeve elektronike, zbatimin e legjislacionit në fuqi dhe ofrimin e shërbimeve efikase dhe transparente.

2. Divizioni për Regjistrin e Pronarëve Përfitues ka detyrat dhe përgjegjësitë në vijim:

2.1 Zhvillon procedurën administrative të regjistrimit të pronarëve përfitues, duke shqyrtuar kërkesat dhe dokumentacionin përkatës të pranuar.

2.2 Zhvillon procedurën administrative të regjistrimit të ndryshimeve, plotësimeve dhe çregjistrimeve të të dhënave të pronarëve përfitues, duke shqyrtuar kërkesat dhe dokumentacionin përkatës të pranuar.

2.3 Vendos të dhënat e pronarëve përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues bazuar në procedurat standarde të veprimit të ARBK-së.

2.4 Pranon dhe verifikon kërkesat nga qendrat komunale për vendosje të të dhënave të pronarëve përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues.

2.5 Përgatit formularë, autorizime dhe procedura standarde për lehtësimin e procedurave të regjistrimit të pronarëve përfitues.

2.6 Kontribuon në dhënien e sqarimeve dhe informacioneve për klientët lidhur me procedurat përkatëse të regjistrimit për pronarët përfitues, në bashkëpunim me njësitë e tjera të ARBK-së, me qëllim të sigurimit të transparencës dhe lehtësimit të procedurave administrative.

2.7 Inicion procedura kundërvajtëse për shkeljet e parapara me ligjin për regjistrimin e pronarëve përfitues.

2.8 Monitoron cilësinë dhe saktësinë e të dhënave të regjistruara në sistemet elektronike, duke zbatuar standarde të kontrollit.

3. Udhëheqësi i Divizionit për Regjistrin e Pronarëve Përfitues i raporton Drejtorit të Departamentit për Regjistra.

4. Numri i të punësuarve në Divizionin për Regjistrin e Pronarëve Përfitues është dhjetë (10).

Neni 11
Divizioni për Regjistrin e Pengut

1. Divizioni për Regjistrin e Pengut ka për qëllim të sigurojë regjistrimin dhe administrimin e të dhënave për pengun, duke garantuar saktësinë dhe integritetin e regjistrit, funksionimin e sistemeve elektronike.

2. Divizioni për Regjistrin e Pengut ka detyrat dhe përgjegjësitë në vijim:

2.1. Zhvillon procedurën administrative të regjistrimit të pengut, duke shqyrtuar kërkesat dhe dokumentacionin përkatës të pranuar.

2.2. Zhvillon procedurën e regjistrimit të ndryshimeve, plotësimeve dhe çregjistrimeve të të dhënave të pengut, duke shqyrtuar kërkesat dhe dokumentacionin përkatës të pranuar.

2.3. Vendos të dhënat e pengut në regjistrin e pengut bazuar në procedurat standarde të veprimit të ARBK-së.

2.4. Pranon dhe verifikon kërkesat nga qendrat komunale për vendosjen e të dhënave të pengut në regjistrin përkatës.

2.5. Publikon të dhënat nga regjistri i pengut në faqen zyrtare, në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi.

2.6. Përgatit dhe publikon formularë, autorizime dhe procedura standarde për lehtësimin e procedurave të regjistrimit të pengut.

2.7. Kontribuon në dhënien e sqarimeve dhe informacioneve për klientët lidhur me procedurat përkatëse të regjistrimit të pengut, në bashkëpunim me njësitë e tjera të ARBK-së, me qëllim të sigurimit të transparencës dhe lehtësimit të procedurave administrative.

2.8. Monitoron cilësinë dhe saktësinë e të dhënave të regjistruara në sistemet elektronike, duke zbatuar standarde të kontrollit.

3. Udhëheqësi i Divizionit për Regjistrin e Pengut i raporton Drejtorit të Departamentit për Regjistra.

4. Numri i të punësuarve në Divizionin për Regjistrin e Pengut është tre (3).

Neni 12
Departamenti për Shërbime dhe të Dhëna

1. Misioni i Departamentit për Shërbime dhe të dhëna është sigurimi i funksionimit efikas, të sigurt dhe transparent të sistemeve digjitale, procedurave administrative dhe shërbimeve ndaj bizneseve, përmes menaxhimit të integruar të të dhënave.

2.Departamenti për Shërbime dhe të dhëna ka detyrat dhe përgjegjësitë në vijim:

2.1.Siguron informim të qartë, orientim paraprak, asistencë teknike dhe komunikim të vazhdueshëm me palët, përmes sportelit, telefonit, email-it dhe platformave digjitale, me biznese lidhur me procedurat në ARBK.

2.2.Publikon dhe shpërndan formularë, procedura, të dhëna dhe raporte të performancës, duke garantuar transparencë, qasje publike dhe përditësim të vazhdueshëm të informacionit zyrtar.

2.3.Administron dhe mirëmban sistemet elektronike të regjistrimit dhe bazat e të dhënave të ARBK-së, regjistrat e Shoqërive Tregtare, Regjistri i Pengut dhe Pronarëve Përfitues duke siguruar funksionim të pandërprerë, integritet dhe siguri të informacionit.

2.4.Përditëson platformat digjitale të shërbimeve online, në koordinim me njësitë e tjera të ARBK-së dhe institucionet kompetente, për të garantuar efikasitet dhe qasje të lehtë për përdoruesit.

3. Drejtori i Departamentit për Shërbime dhe të dhëna i raporton Drejtorit Ekzekutiv të ARBK-së.

4.Numri i të punësuarve në Departamentin për Shërbime dhe të Dhëna është nëntë (9).

Neni 13
Divizioni për Mbështetje dhe Edukim të Bizneseve

1. Divizioni për Mbështetje dhe Edukim të Bizneseve ofron informim, asistencë dhe mbështetje profesionale për bizneset dhe qytetarët lidhur me procedurat e regjistrimit, duke promovuar përdorimin e shërbimeve digjitale, transparencën dhe cilësinë e shërbimeve të ARBK-së.

2. Divizioni për Mbështetje dhe Edukim të Bizneseve, ka detyrat dhe përgjegjësitë në vijim:

2.1 Informon subjektet për procedurat e regjistrimit, ndryshimeve, plotësimeve dhe çregjistrimeve në sportel dhe përmes shërbimeve online në ARBK;

2.2 Ofron asistencë paraprake për palët, duke i orientuar në zgjedhjen e llojit të duhur të aplikimit, dokumentacionit të nevojshëm dhe kërkesave ligjore përkatëse.

2.3 Publikon dhe siguron shpërndarjen e formularëve, autorizimeve dhe procedurave standarde të përgatitura nga njësitë përkatëse të ARBK-së, me qëllim të lehtësimit dhe unifikimit të procedurave të regjistrimit;

2.4 Menaxhon komunikimin hyrës të palëve, përmes telefonit, email-it dhe platformave digjitale, duke ofruar sqarime, udhëzime dhe përgjigje për pyetjet e përgjithshme dhe të veçanta;

2.5 Ofron asistencë teknike dhe udhëzime për përdorimin e platformave digjitale dhe dokumenteve fizike për aplikim;

2.6 Komunikon në mënyrë të vazhdueshme me aplikuesit dhe subjektet e tjera për statusin e kërkesave dhe afatet e procedurave;

2.7 Njofton palët dhe subjektet e tjera në momentin e përfundimit të procedurës, kur realizohet regjistrimi, ndryshimi apo plotësimi i të dhënave;

2.8 Koordinohet me njësitë e tjera të ARBK-së për të siguruar koherencë të informacionit dhe përditësim të vazhdueshëm të përmbajtjes së publikuar, dhe

2.9 Siguron transparencë dhe qartësi në komunikimin me publikun, duke kontribuar në rritjen e cilësisë së shërbimeve dhe kënaqshmërisë së palëve.

3. Udhëheqësi i Divizionit për Mbështetje dhe Edukim të Bizneseve i raporton Drejtorit të Departamentit për Shërbime dhe të Dhëna.

4. Numri i të punësuarve në Divizionin për Mbështetje dhe Edukim të Bizneseve është katër (4).

Neni 14
Divizioni për Shërbime Digjitale dhe të Dhëna

1. Divizioni për Shërbime Digjitale dhe të Dhëna ka për qëllim të sigurojë funksionimin e qëndrueshëm, të sigurt dhe efikas të sistemeve digjitale dhe regjistrave elektronikë të ARBK-së, duke garantuar integritetin dhe mbrojtjen e të dhënave, zhvillimin dhe integrimin e shërbimeve elektronike, mbështetjen teknike për stafin, si dhe ofrimin e të dhënave dhe raporteve të besueshme për institucionet dhe publikun.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Shërbime Digjitale dhe të Dhëna janë:

2.1. Administron dhe mirëmban sistemet elektronike të regjistrimit dhe bazat e të dhënave të ARBK-së, përfshirë regjistrin e shoqërive tregtare, regjistrin e pronarëve përfitues dhe regjistrin e pengut, duke siguruar funksionim të pandërprerë, integritet dhe siguri të informacionit.

2.2.Monitoron cilësinë dhe saktësinë e të dhënave të regjistruara në sistemet elektronike, duke zbatuar standarde të kontrollit dhe auditimit të brendshëm.

2.3. Siguron mbrojtjen e të dhënave personale dhe konfidenciale, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave dhe politikat e sigurisë kibernetike të institucionit.

2.4. Ofron mbështetje teknike dhe trajnime për stafin e ARBK-së në përdorimin e sistemeve dhe aplikacioneve digjitale, si dhe në zgjidhjen e problemeve të përditshme teknike.

2.5.Koordinon integrimin e sistemeve të ARBK-së me platformat e tjera shtetërore dhe ndërinstitucionale dhe bashkëpunon me institucionet shtetërore për shkëmbimin e të dhënave, për të mundësuar shkëmbim të sigurt dhe efikas të të dhënave publike.

2.6. Publikon të dhënat dhe dokumentet e regjistrave në faqen zyrtare të ARBK-së, në përputhje me kërkesat e ligjeve përkatëse në fuqi.

2.7.Mbledh të dhëna statistikore dhe publikon raporte të performancës që vlerësojnë efektivitetin e shërbimeve të regjistrimit në nivel qendror dhe komunal.

3. Udhëheqësi i Divizionit për Shërbime Digjitale dhe të Dhëna i raporton Drejtorit të Departamentit për Shërbime dhe të Dhëna.

4. Numri i të punësuarve në Divizionin për Shërbime Digjitale dhe të Dhëna është katër (4).

KAPITULLI III
DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 15
Dispozitat përfundimtare

Pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje është Shtojca I e cila përmban numrin e përgjithshëm të të gjithë të punësuarve në ARBK dhe numrin e veçantë për secilën njësi, si dhe Shtojca II e cila përmban organogramin vizual.

Neni 16
Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohet Rregullorja (ZKM) nr. 08/2023 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të Agjencisë për Regjistrim të Bizneseve në Kosovë.

Neni 17
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin Kurti

_____
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Datë: 16 nëntor 2026

SHTOJCA I - Struktura organizative dhe numri i përgjithshëm i gjithë të punësuarve

VENDET E PUNËS SË AGJENCISË PËR REGJISTRIMIN E BIZNESEVE TË KOSOVËS			
POZITA/STRUKTURA	**KLASA**	**GRUPI (I PËRGJITHSHËM OSE I VEÇANTË)**	**NUMRI**
1. ZYRA E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM			**Total: 6**
Drejtori Ekzekutiv	Drejtues i Lartë	N/A	1
Zyrtar i Lartë Ekzekutiv	Profesional 1	SHC-0168, Grupi i shkencave shoqërore	1
Asistent administrativ	Profesional 3	SHC-0006 Grupi i administrimit të përgjithshëm	1
Zyrtar i lartë për raporte dhe analiza	Profesional 1	SHC-0732 Grupi i administrimit të përgjithshëm	1
Zyrtar i lartë për komunikim me publikun	Profesional 1	SHC-0464, Grupi i marrëdhënieve me publikun dhe informim	1
Zyrtar i lartë për monitorim dhe kontroll	Profesional 1	SHC-0578, Grupi i administrimit të përgjithshëm	1
2. DEPARTAMENTI PËR REGJISTRA			**Total: 33**
Drejtori	Drejtues i Mesëm		1
2.1. Divizioni për Regjistrin e Shoqërive Tregtare			**19**
Udhëheqësi i Divizionit	Drejtues i Ulët		1
Zyrtar/e i/e për Procesim të të dhënave	Profesional 2	SHC-1366, Grupi i Shkencave Shoqërore	8

Zyrtar/e i/e Lartë për Aprovimin e Lëndëve	Profesional 1	SHC- 0287, Grupi ligjor	8
Zyrtar për administrimin e dokumenteve	Profesional 2	SHC-1013, Grupi i arkiv-dokumentacionit	1
Zyrtar për çështje praktike dhe regjistrim biznesi	Profesional 2	SHC-1083 Grupi ligjor	1
2. 2 Divizioni për Regjistrin e Pronarëve Përfitues			**Total: 10**
Udhëheqësi i Divizionit	Drejtues i Ulët		1
Zyrtar/e i/e për Aprovimin e Lëndëve	Profesional 1	SHC- 0287, Grupi ligjor	5
Zyrtar/e i/e Lartë për koordinim të verifikimit	Profesional 1	SHC-0491, Grupi i administrimit të përgjithshëm	4
2.3. Divizioni për Regjistrin e Pengut			**Total: 3**
Udhëheqësi i Divizionit	Drejtues i Ulët		1
Zyrtar i/e për Regjistrin e Pengut	Profesional 2	SHC-1405, Grupi i administrimit të përgjithshëm	2
3. DEPARTAMENTI PËR SHËRBIME DHE TË DHËNA			**Total: 9**
Drejtori	Drejtues i Mesëm		1
3.1 Divizioni për Shërbime Digjitale dhe të dhëna			**Totali: 4**

Udhëheqësi i Divizionit	Drejtues i Ulët	N/A	1
Zyrtar/e i/e Lartë për Administrimin e Platformave Elektronike	Profesional 1	SHC-0913, Grupi i teknologjisë	3
3.2 Divizioni për Mbështetje dhe Edukim të Bizneseve			**Total: 4**
Udhëheqësi i Divizionit	Drejtues i Ulët		1
Zyrtar i Lartë për Shërbim me Qytetarë	Profesional 1	SHC-0761, Grupi i administrimit të përgjithshëm	1
Zyrtar i Lartë për Shqyrtimin e Ankesave	Profesional 1	SHC-0778, Grupi ligjor	1
Zyrtar i Trajnimit për Administrim Biznesi	Profesional 2	SHC-0969, Grupi i ekonomisë	1
Gjithsej			**48**

AGJENCIA PËR REGJISTRIMIN E BIZNESEVE TË KOSOVËS (ARBK)

Shtojca 2 (Organogrami)

